

Raffaello

ritrattista

Raffaello nacque a Urbino il 6 Aprile del 1483. Il padre Giovanni Santi gestiva la più importante bottega pittorica della città. Pittore di qualità, intellettuale di corte, uomo di lettere, Giovanni Santi era fiduciario del duca di Urbino per le questioni artistiche. La prima educazione all'arte di Raffaello bambino avvenne dunque nella bottega del padre e all'interno del Palazzo Ducale, a contatto con i capolavori dell'arte italiana e fiamminga (Piero della Francesca, Giovanni Bellini, Jan van Eyck) li custoditi. Giovanni Santi morì nel 1494 e Raffaello che i documenti nominano "maestro" già all'età di 17 anni, ne ereditò la bottega che gestì insieme ad Evangelista di Pian da Meleto. Ci fu poi, per il giovanissimo Raffaello, il contatto con Pietro Perugino dal quale apprese, per non dimenticarlo mai più, il segreto del ritmo che governa le forme e della bellezza che le illumina e le intenerisce.

Nel 1504 il pittore ventunenne prende residenza a Firenze dove rimarrà per quattro anni. Qui il suo stile cresce e si sviluppa grazie alla conoscenza dei capolavori di Michelangelo e di Leonardo, attivi in quegli anni nel Salone dei Cinquecento in Palazzo Vecchio per dipingervi, rispettivamente, la *Battaglia di Cascina* e la *Battaglia di Anghiari*; grazie al contatto con i maestri della "Scuola di San Marco" (Fra Bartolomeo e Mariotto Albertinelli); grazie – dice il Vasari – allo studio dei "maestri vecchi" (Masaccio, Beato Angelico, Luca della Robbia).

Nel 1508, presentato dall'architetto Donato Bramante al quale era legato dalla comune patria marchigiana oltre che da vincoli di parentela ma già comunque celebre presso la corte pontificia, per i successi fiorentini e considerato un prodigio di bravura e quasi lo stupore del secolo, il venticinquenne Raffaello entra al servizio di papa Giulio II della Rovere. Per lui dipinge ad affresco le pareti del suo appartamento privato, il luogo dei Palazzi Apostolici, oggi percorso dei Musei Vaticani, che da allora in poi tutto il mondo conoscerà come *Le Stanze*. Con Giulio II prima, con Leone X Medici poi, si moltiplicano i successi romani di Raffaello. Nel 1519 inaugura il cantiere delle Logge nei Palazzi Apostolici, nel Dicembre dello stesso anno i primi sette arazzi con le storie degli Apostoli Pietro e Paolo tessuti (su cartoni di Raffaello) nell'atelier di Pieter van Aelst a Bruxelles, vengono collocati nella Cappella Sistina.

Raffaello è al vertice della fortuna. Papa Leone lo nomina Conservatore delle Antichità o Soprintendente di Roma, per il ricchissimo banchiere Agostino Chigi dipinge gli affreschi nella sua villa Farnesina (la *Galatea* e la *Loggia di Psiche*) è conteso dai cardinali e dai sovrani d'Italia e d'Europa, è ricco, ammirato e invidiato dagli uomini, amato dalle donne.

Nella primavera del 1520, questo giovane uomo che dalla vita ha avuto tutto, successo, denaro, amore, l'ammirazione dei grandi della terra, si ammala e muore nel giro di pochi giorni, probabilmente ucciso dalle febbri malariche, endemiche e sovente letali nella Roma di allora. Muore il 6 Aprile del 1520, Venerdì Santo, lo stesso giorno della sua nascita, avvenuta trentasette anni prima. Raffaello è sepolto a Roma, nella chiesa del Pantheon.

(Antonio Paolucci)

Raffaello lindi në Urbino më 6 Prill të vitit 1483. I ati, Giovanni Santi, drejtonte më të rëndësishmen punishte pikturash në qytet. Piktur cilësor, intelektual oborri, njeri i penës, Giovanni Santi ishte i besuar i dukës së Urbino-s për çështjet artistike. Mësimet e para mbi artin, Raffaello fëmijë i mori pra në punishten e të atit dhe brenda Pallatit të Dukës, në kontakt me kryeveprat e artit italian dhe atij flamand (Piero della Francesca, Giovanni Bellini, Jan van Eyck) të ruajtura aty. Giovanni Santi u nda nga jeta në vitin 1494 dhe Raffaello i cili në dokumenta quhet "mjeshër" që në moshën 17 vjeçare, trashëgoi punishten të cilën e drejtoi së bashku me Evangelista di Pian da Meleto. Më pas, rioshi Raffaello, u takua me Pietro Perugino-n nga i cili mësoi, për të mos e harruar më kurrë, sekretin e ritmit që udhëheq format dhe të bukurisë që u jep dritë e i zbut ato.

Në vitin 1504 piktori njëzetë e një vjeçar zhvendoset në Firenze ku do të qëndrojë për katër vite. Këtu stili i tij rritet e zhvillohet falë njohurive mbi kryeveprat e Michelangelo-s e të Leonardo-s, aktivë në ato vite në Salone dei Cinquecento në Palazzo Vecchio për të pikturuar, përkatësisht, *Battaglia di Cascina* dhe *Battaglia di Anghiari*; falë kontaktit me mjeshtrat e "Scuola di San Marco" (Bartolomeo dhe Mariotto Albertinelli); falë – siç thotë Vasari – të studiuarit të "mjeshtrave të vjetër" (Masaccio, Beato Angelico, Luca della Robbia).

Në vitin 1508, i prezantuar nga arkitekti Donato Bramante me të cilin kishte të përbashkët vendlindjen e tij në zonën e Marche përveç lidhjeve farefisnore, por gjithsesi tashmë i famshëm në rrethin papnor, në sajë të sukseseve në Firenze dhe i konsideruar me aftësi të jashtëzakonshme, gati gati, habia e shekullit, njëzetë e pesë vjeçari Raffaello hyn në shërbim të papës Giulio II della Rovere. Për të pikturon me afreske muret e apartamentit të tij privat, vendin e Pallateve Apostolike, sot rrugë e Muzeve të Vatikanit, që, prej atëherë e gjithë bota do t'a njohë si *Dhomat*. Me Giulio II më parë e me Leone X Medici më pas, sukseset në Romë të Raffaello-s shumëfishohen. Në vitin 1519 inauguron kantierin e Llozhave në Pallatet Apostolike në Dhjetorin e të njëjtit vit shtatë shtatë e para me historitë e Apostujve Pietro e Paolo të realizuara (mbi skicat e Raffaello-s) në atelienë e Pieter van Aelst në Bruksel, vendur në Cappella Sistina.

Raffaello arrin majat e fatit. Papa Leone e emëron Ruajtës të Antikitetit apo Mbikqyrës të Romës, për bankierin shumë të pasur Agostino Chigi realizon afresket në vilën e tij Farnesina (*Galatea* dhe *Loggia di Psiche*), i kërkuar nga kardinalët dhe nga sovranët e Italisë e Evropës, ai është i pasur, i admiruar dhe i parë me zili nga burrat por i dashuruar nga gratë.

Në pranverën e vitit 1520, ky burrë i ri që nga jeta pati gjithçka, sukses, para, dashuri, admirimin e të fuqishmëve të tokës, sëmurët e vdes brenda pak ditësh, ndoshta nga temperatura endemike dhe shpesh vdekjeprurëse e shkaktuar nga malarja në Romën e atëhershme. Vdes më 6 Prill të vitit 1520, të Premten e Madhe, në ditën e tij të lindjes tridhjetë e shtatë vite më parë. Raffaello është varrosur në Romë, në kishën e Pantheon.